



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "*Njësia e Prokurimit*", të cilën e përfaqëson znj, *Zizë Bujupaj*, menaxhere e Prokurimit, Rruga "*Fadil Ferati*" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"TERMOMONTIMI" SHPK nga Prishtina, të cilën e përfaqëson z. *Fatmir Mecinaj*, në cilësinë e Menaxherit të Ndermarres me Nr. Rexh. Biznesi, 71144410 (në vazhdim "*Kontraktuesit*"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK DHE TROTUAREVE NË BANJË – LOT 1

Nr. I prokurimit	633-18-7251-5-2-1/C 167 - Lot 1
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 071/ 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK DHE TROTUAREVE NË BANJË

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK DHE TROTUAREVE NË BANJË është: 56.810,50 € dhe me fjalë: /Pesëdhjetëegjashtë mijë e tetë qind e dhjetë euro 50/100 €

2.2. Çmimi prej 50,000,00 € kontraktorit do t'i paguhet pas realizimit të punimeve deri në vlerë të këtij çmimi, ndërsa shuma e mbetur deri në vlerën e ofertës financiare prej 6.810,50 € do t'i behet pas sigurimit të burimit financiar.

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borch Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet
Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për


pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
"Termomontimi" Shpk

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Fatmir Mecinaj
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	 30.11.2018
Data:	30.11.2018	Data:	
Vula		Vula	

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha SHQIPE
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: sipas Ligjeve në fuqi që rregullojnë lemin e siguracioneve.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3. ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	10	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është: 10% e shumës totale të kontratës, në një afat prej 90 ditësh
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë, pas nënshkrimit të kontratës, gjegjësisht me datë kur menaxheri i kontratës e përcakton në ditarin e punës dhe Librin ndërtimor si dhe PLANIN PER MENAXHIM TE KONTRATËS
Përfundimi i punimeve	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve dhe furnizimeve do të jetë: 60 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara		Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë llogaritura për ditë dhe atë 0.25 % për ç'do ditë vonese të paarsyeshme. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të

	19.1	gjitha Punët është 10 % e çmimit final të Kontratës. Në qofte se kontraktori nuk i kryen punimet ne afatin e paraparë me kontratë, pa fajin e tijë, menaxheri i projektit duhet arsyetuar vonesen dhe shkaqet të cilat e kan vonuar dinamikën e punimeve.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrësi i kontratës caktohet z. Rasim Mahmutoviq, i cili do te kujdeset per rrjedhën dhe implementimin e kontratë deri ne perfundimin e plote të sajë.
Pagesat	24.1	Pagesat do te bëhen në euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës bazuar ne raportin e mbikqyrësit, pas kryerjes së punimeve per situacionet përkatëse.
Përmirësimi i defekteve	31.1	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë, pas perfundimit te punimeve, bazuar ne deklaraten e kontraktorit.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.1	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të jetë Arbitrazhi – pranë Odes Ekonomike Prishtinë.